



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FIER

Nr. 1130 Prot.

Fier, më ____ .09.2026

BASHKIA FIER

NJOFTIM PËR BOTIM PËR DHËNIE ME QIRA

Në zbatim të ligjit 139/2015 “Për vetqeverisjen vendore” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 54 dt. 05.02.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 101 dt. 19.12.2017, nr. 99 dt. 31.10.2022 dhe nr. 53 dt. 17.05.2023 “Për miratimin e fillimit të procedurave për dhënie me qira të sipërfaqjeve “tokë pa frut”, të ndodhura në fshatin Sheq Marinas dhe Grykë, Njësia Administrative Topojë, Bashkia Fier”, Bashkia Fier do të realizojë procedurën për dhënie me qira me konkurim të pasurisë **nr. 554/8 zk. 3358 me sipërfaqje 76 000 m² “tokë pa frut”**, Bashkia Fier, pronë e Bashkisë Fier. Dhënia me qira e pasurisë jepet me qëllim ushtrimin e aktivitetit në fusha të ndryshme sipas përcaktimeve të VKM nr. 54 dt. 05.02.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, i ndryshuar.

Vlera dysheme për detyrimin e qirasë për fillimin e ankandit do të jetë 27 000 lekë ha/vit.

Afati i dhënies me qira të kësaj pasurie është deri 20 vjet.

Vlerësimi i ofertave të konkurentëve do të bëhet me pikët si vijon:

a) Niveli i investimit	30 pikë
b) Niveli i punësimit	10 pikë
c) Përvoja në fushën e aktivitetit që do të ushtrohet	5 pikë
d) Oferta e detyrimit mujor të qirasë	55 pikë

Konkurimi do të zhvillohet në **dt. 25.09.2026 ora 11.00** në Bashkinë Fier sipas procedurave të parashikuara në VKM nr. 54 dt. 05.02.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, i ndryshuar.

Në ngarkim të “Qiramarrësit” janë të gjitha tatimet dhe detyrimet që rëndojnë mbi pronën e dhënë me qira sipas legjislacionit në fuqi.

Konkurentët do të dërgojnë në adresën zyrtare elektronike të institucionit info@bashkiafier.gov.al, në datën dhe orën e caktuar, deri në dt. 25.09.2026 ora 11.00 dokumentacionin si vijon:

- Kërkesën e subjektit për marrje me qira të pasurisë shtetërore;
- Planbiznesin e hollësishëm për vënien në funksion të objektit, ku të përshkruhen qartë; plani i punësimit, plani i investimeve si dhe treguesit që do të realizohen;
- Ofertën për vlerën e detyrimit mujor të qirasë;
- Çertifikatën e rregjistrimit dhe çertifikatën historike të rregjistrimit të subjektit në QKR;

NUIS – in dhe vërtetimin nga dega e tatimeve se subjekti ka shlyer detyrimet tatimore dhe sigurimet shoqërore;

- Vërtetime nga institucionet përkatëse që nuk është në ndjekje penale, si dhe nuk ka procese gjyqësore në lidhje me aktivitetin.

KRYETARI

Armando SUBASHI

